

PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME:

Kontakt: Ana Kadovic, [akovacevic@ndi.org](mailto:akovacevic@ndi.org); +355 (04)22771281

## **HULUMTIMI I NDI: KËRKESË PËR MUNDËSI EKONOMIKE DHE SUNDIM TË LIGJIT**

Tiranë, Shqipëri – Shqetësime rreth papunësisë, çmimeve të larta dhe barrës së taksave u ngritën nga një numër pjesëmarrësish që morën pjesë në hulumtimin përmes grupeve të fokusuara organizuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI) në dhjetorin e vitit të kaluar.

Këto shqetësime aktuale kundërpeshojnë vlerësimin e shumicës së pjesëmarrësve se Shqipëria përgjithësisht po ecën në drejtimin e duhur.

Shumica e pjesëmarrësve thanë se mbështesin iniciativat e fundit mbi zbatimin e ligjit por disa janë të shqetësuar se ky zbatim i ligjit nuk po bëhet në mënyrë konsistente. Ata janë të irrituar nga grindjet partiake që denigrojnë e poshtërojnë institucionet publike dhe ligjërimin politik.

Gjetje të tjera kryesore:

- Ndryshe nga gjetjet e viteve të kaluara, korrupsioni nuk u rendit ndër prioritetet kryesore. Megjithatë, korrupsioni u përmend rëndom në komentet rreth ekonomisë dhe çështjeve sociale, veçanërisht në fusha si shëndetësia, arsimi dhe drejtësia. Pjesëmarrësit dëshirojnë punësim në baza meritokracie në administratën publike e cila shpesh perceptohet si nepotike dhe bazuar në lidhje politike. Disa pjesëmarrës perceptojnë një zbatim selektiv të ligjit duke favorizuar personat e pasur dhe me lidhje politike.
- Mbështetja për integrimin në Bashkimin Europian mbetet e lartë dhe lidhet kryesisht me pritshmeritë për rritje dhe mundësi ekonomike.
- Kishte një mbështetje në parim për reformën administrative vendore të ndërmarrë nga qeveria, por pjesëmarrësit ndiheshin të paqartë rreth përmbajtjes specifike të paketës së reformës.
- Vërehet një irritim i dukshëm me sulmet përçmuese të politikanëve ndaj kundërshtarëve politikë, i cili vijon nga gjetjet e hulumtimeve të dy viteve të shkuara. Pjesëmarrësit gjithashtu kritikuan atë çfarë ata shohin si paaftësi e politikanëve për të vënë në jetë premtimet.
- Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara mirëpresin pjesëmarrjen e grave në politikë. Ata i shohin gratë e zgjedhura si të gatshme për t'ju përgjigjur interesave të publikut dhe si zëra më konstruktivë në dialogun politik.

*“Pjesëmarrësit në diskutime janë kryesisht të kënaqur nga iniciativat e fundit e qeverisë për të ndaluar humbjet në sektorin e energjisë, prishjen e ndërtimeve pa leje dhe mbylljen e universiteteve private që shiheshin si shitës diplomash. Në të njëjtën kohë, shqetësimet e thella rreth ekonomisë, kohezionit social, dhe perspektivës së qytetarëve rreth të ardhmes së tyre dhe asaj të familjes i vënë në plan të dytë këto këndvështrime pozitive.”* thotë Drejtoresha e NDI në Shqipëri, Ana Kadovic.

10 grupe të fokusuara u zhvilluan në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë. Hulumtimi përmes grupeve të fokusuara u zhvillua në partneritet me IDRA Research & Consulting dhe u financua nga Ndihma Amerikane për Demokraci (NED). Gjetjet e grupeve të fokusuara janë tregues i mendimit publik por nuk reflektojnë opinionin publik në mënyrë statistikore.

###

Instituti Demokratik Amerikan [www.ndi.org](http://www.ndi.org) është një organizatë jo-fitimprurëse, jo-partiake, jo-qeveritare që punon për të mbështetur institucionet demokratike në mbarë botën.